

<p><i>Acquis</i> së BE-sëqë synohet të përafrohet (Nr. CELEX, Nr. Natyral, lloji i aktit, institucioni që e ka miratuar, data e miratimit, titulli i plotë dhe numri i Fletores Zyrtare)  <b>CELEX: 02006L0118-20140711 DIREKTIVA 2006/118/KE E PARLAMENTIT EUROPIAN DHE E KESHILLIT, datë 12 Dhjetor 2006</b>  <b>“për mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja dhe përkeqësimi”</b>  (OJ L 372/19, 27.12.2006)</p>		Legjislacioni shqiptar i propozuar (titulli i projektaktit) <b>Projekt Ligj “Për Burimet Ujore”</b> Shkalla e përafrimit(një nga tre mundësitë e mëposhtme) në total e projekt-aktit Përputhshmëri e plotë Përputhshmëri e pjesshme I papërputhur  Shkalla e Përafrimit e pjesshme				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Teksti	Përputhshmëria	Shënime
Në këtë kolonë shënohet vetëm numri i nenit të instrumen tit të <i>acquis</i> së BE-së që përafrohet ose i paragrafit apo nënparagrafit.	Në këtë kolonë shënohet teksti i nenit që i korrespondon numri në kolonën e parë. Sipas rastit, çdo nen mund të copëzohet në paragrafë apo nënparagrafë, duke vendosur secilin në një rresht të veçantë.	Në rastin kur projektaktet që përafrohen janë më shumë se një, atëherë ato numërtohen dhe në këtë kolonë shënohet numri përkatës i referencës	Në këtë kolonë shënohet numri i nenit të projektit	Në këtë kolonë shënohet teksti i nenit, ose i pjesëve të nenit, që i korrespondon numri në kolonën e katërt dhe që ka përafruar kërkesat e nenit të <i>acquis</i> së BE-së në kolonën e dytë.	Në këtë kolonë shënohet shkalla e përafrimit për çdo nen të veçantë.	Në këtë kolonë jepen shënime në lidhje me shkallën e përafrimit. Kur përafrimi nuk është i plotë, jepen arsyet dhe afatet se kur do të bëhet përafrimi i plotë.
Neni 2, pika 1	‘standarti i cilësisë së ujërave nëntokësore’ do të thotë: një standart cilësie mjedisore i shprehur si përqëndrimi i një ndotësi të vecantë, grupi ndotësish ose indikator të		Neni 3, pika 69	69. “Standardi i cilësisë së ujërave nëntokësore” është një standart i cilësisë mjedisore si përqëndrimi i një ndotësi të caktuar apo një grupi ndotësish, apo tregues ndotësi në ujërat	E plotë	

	ndotjes në ujërat nëntokësore, të cilat nuk duhet të tejkalohen në mënyrë që të mbrohet shëndeti i njeriut dhe mjedisit;			nëntokësorë, që nuk duhet të tejkalohet në kuadër të mbrojtjes së shëndetit njerëzor dhe mjedisit.		
Neni 2, pika 2	‘vlëra kufi’ do të thotë: një standart cilësie mjedisore i përcaktuar nga Shtetet Anëtare në përputhje me Nenin 3;		Neni 3, pika 112	112. “Vlera prag” është standardi i cilësisë së ujërave nëntokësorë i përcaktuar në përputhje me nenin 61, pika 1 e këtij ligji.	E plotë	Referenca e vendosur në nenin 2, pika 2 e Direktivës( neni 3) është transpozuar nga parashikimet e projektligjit (neni 61, pika 1)
Neni 2, pika 3	‘ tendencë domethënëse dhe e qëndrueshme në rritje’ do të thotë: çdo rritje domethënëse statistikore dhe mjedisore të përqëndrimit të një ndotësi, grupi ndotësish ose indikatorëve të ndotjes në ujërat nëntokësore për të cilat ndryshimi i tendencës është identifikuar i nevojshëm në përputhje me Nenin 5;		Neni 3, pika 56	56. “Prirje e konsiderueshme dhe e qëndrueshme në rritje” është çdo rritje statistikore dhe mjedisore e konsiderueshme e përqëndrimit të një ndotësi, grupi ndotësish, ose treguesi të ndotjes në ujërat nëntokësore për të cilin përmbysja e prirjes është identifikuar si e nevojshme në përputhje me nenin 64 të këtij ligji.	E plotë	Referenca e vendosur në nenin 2, pika 3 e Direktivës( neni 5) është transpozuar nga parashikimet e projektligjit (neni 64)
Neni 2, pika 4	‘inpute të ndotësve në ujërat nëntokësore’ do të thotë: futja e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë e ndotësve në ujërat nëntokësore si rezultat i aktivitetit të njeriut;		Neni 3, pika 13	13. “Injektim i ndotësve në ujëra nëntokësore” është hyrja e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e ndotësve në ujërat nëntokësore si pasojë e aktivitetit njerëzor.	E plotë	
Neni 2, pika 5	‘niveli background/sfond’ do të thotë: përqëndrimi i një substance ose vlëra e një indikatorit në një trup të ujërave nëntokësore që korespondon me asnjë, ose vetëm shumë të vogla, ndryshime antropogjene në kushte të qeta;		Neni 3, pika 41	41. “Niveli fillestar” është përqëndrimi i një lënde ose vlëra e një treguesi në një trup ujeje nëntokësore që nuk korespondon, ose korespondon shumë pak me ndryshimet antropogjene, në kushte normale.	E plotë	
Neni 2, pika 6	‘niveli bazë’ do të thotë: vlëra mesatare e matur të paktën gjatë		Neni 3, pika 40	40. “Niveli bazë” është vlëra mesatare e matur të paktën gjatë	E plotë	Referenca e vendosur në nenin 2 pika 6 e Direktivës

	viteve referencë 2007 dhe 2008 në bazë të programeve të monitorimit të implementuara sipas Nenet 8 të Direktivës 2000/60/KE, ose në rastin e substancave të identifikuar pas këtyre viteve referencë, gjatë periudhës së parë për të cilën është e vlefshme një periudhë përfaqësuese e monitorimit të të dhënave.			viteve të referencës bazuar në programe të monitorimit të zbatuara sipas neneve 41 dhe 65 të këtij ligji ose, në rastin e substancave të identifikuar pas këtyre viteve të referencës, gjatë periudhës së parë për të cilën është në dispozicion një periudhë përfaqësuese me të dhëna monitorimi.		(neni 8 i Direktivës 2000/60) është transpozuar plotësisht nga parashikimet e projektligjit (neni 41)
Neni 3 pika 1	Për qëllim të vlerësimit të statusit kimik të një trupi ose të një grupi trupash të ujërave nëntokësore në zbatim të Seksionit 2.3 të Aneksit V të Direktivës 2000/60/KE, Shtetet Anëtare do të përdorin kriteret e mëposhtme:		Neni 62, pika 1	1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për vlerësimin e statusit kimik të një trupi apo grupi trupash ujorë nëntokësorë, bazohet në:	E plotë	
Neni 3 pika 1, germa (a)	standartet e cilësisë të ujërave nëntokësore referuar në Aneksin I;		Neni 62, pika 1, germa (a)	a) standartet e cilësisë për ujërat nëntokësorë të përcaktuara në përputhje me nenin 60 të këtij ligji;	E plotë	
Neni 3, pika 1, germa (b)	vlerat kufi do të përcaktohen nga Shtetet Anëtare në përputhje me procedurën e përcaktuar në Pjesën A të Aneksit II për ndotësit, grupët e ndotësve dhe indikatorët e ndotjes të cilët, brenda territorit të një Shteti Anëtar, janë identifikuar si kontribues në karakterizimin e trupit ose trupave të ujërave nëntokësore që janë në rrezik, duke marrë parasysh të paktën listën që		Neni 62, pika 1, germa (b)	b) vlerat prag të përcaktuara në përputhje me nenin 61 të këtij ligji.	E plotë	

	përmbahet në Pjesën B të Aneksit II.					
Neni 4, pika 5	Nëse një trup i ujërave nëntokësore është klasifikuar me një status të mirë kimik në përputhje me paragrafin 2(c), Shtetet Anëtare, në përputhje me Nenin 11 të Direktivës 2000/60/KE, do të marrin masa të nevojshme për të mbrojtuar ekosistemet ujore, ekosistemet tokësore dhe përdorimet e njeriut të ujërave nëntokësore, që varen në pjesën e trupit të ujërave nëntokësore të përfaqësuar nga pika ose pikat e monitorimit në të cilat vlera për një standart cilësie të ujërave nëntokësore ose vlera kufi është tejkaluar.		Neni 62, pika 2	Nëse një trup ujor nëntokësor, pas vlerësimit sipas pikës 1 të këtij neni, klasifikohet me status të mirë kimik, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore merr masat e nevojshme në përputhje me këtë ligj për mbrojtjen e ekosistemeve ujore, ekosistemeve tokësore dhe përdorimit njerëzor të ujërave nëntokësore që varen nga pjesa e trupit ujor nëntokësor të përfaqësuar nga pika apo pikat e monitorimit, ku vlera për standardin e cilësisë së ujërave nëntokësore apo vlera standard është tejkaluar.	E plotë	Referenca e vendosur në nenin 4 pika 5 e Direktivës (neni 11 i Direktivës 2000/60) është transpozuar plotësisht nga parashikimet e projektligjit. (nenet 44, 45, 46, 47 pikat 1 dhe 2, 48 pika 1, 49, 50, 51, 58 pika 1a 1b, 65 të projektligjit)
Neni 3, paragrafi i fundit i pikës 1	Vlerat kufi të zbatueshme për statusin e mirë kimik do të bazohen për mbrojtjen e trupit të ujërave nëntokësore në përputhje me Pjesën A, pika 1, 2 dhe 3 të Aneksit II, duke i kushtuar vëmendje të veçantë të impaktit të tij, dhe ndërlidhjes me ujërat sipërfaqësore në lidhje me të dhe ekosistemet tokësore që varen drejtpërdrejtë dhe ligatinat dhe, ndër të tjera, duhet të marrë parasysh njohuritë njerëzore për toksikologjinë dhe ekotoksikologjinë.		Neni 61, pika 1	1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore përcakton vlerat prag për ndotësit, grupet e ndotësve dhe treguesit e ndotjes që zbatohen për statusin e mirë kimik dhe që bazohen në mbrojtjen e trupit ujor nëntokësor, duke pasur në konsideratë të veçantë ndikimin mbi dhe ndërveprimin me ujërat përkatëse sipërfaqësore dhe ekosistemet tokësore që varen drejtpërsëdrejti prej tyre dhe tokat moçalore, si dhe ndër të tjera merr në konsideratë njohuritë për	E plotë	

				toksikologjinë njerëzore dhe toksikologjinë ekologjike.		
Neni 3, pika 2	Vlerat kufi mund të përcaktohen në nivel kombëtar, në nivelin e rretheve të baseneve lumore ose ojesë të rretheve të baseneve lumore ndërkombëtare që bien brënda territorit të një Shteti Anëtar, ose në nivel të një trupi ose grup trupash të ujërave nëntokësore.		Neni 61, pika 2	2. Vlerat prag sipas pikës 1 të këtij neni mund të përcaktohen në nivel të një trupi apo grupi trupash ujorë nëntokësorë, në nivelin e rajonit të basenit lumor ose të pjesës së rajonit të basenit lumor që ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë, ose në nivel kombëtar.	E plotë	
Neni 3, pika 3	Shtetet Anëtare, për trupat e ujërave nëntokësore që ndahen nga dy ose më shumë Shtete Anëtare dhe për trupat e ujërave nëntokësore brënda të cilëve ujërat nëntokësore rrjedhin përmes kufijve të një Shteti Anëtar, do të sigurojnë që përcaktimi i vlerave kufi është subjekt i koordinimit midis Shteteve Anëtare në fjalë, në përputhje me Nenin 3(4) të Direktivës 2000/60/KE.		Neni 61, pika 3	3. Në rastin e ujërave ndërkufitare, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore sigurohet që vlerat prag për trupat ujorë nëntokësorë që ndahen midis Shqipërisë dhe vendeve fqinje të përcaktohen përmes bashkërendimit me vendet fqinje përkatëse.	E plotë	
Neni 3, pika 5	Shtetet Anëtarë do të përcaktojnë vlerat kufi në përputhje me paragrafin 1(b), për herë të parë më 22 Dhjetor 2008.		Neni 61, pika 4	4. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore përcakton vlerat e para prag në përputhje me pikën 1 të këtij neni brenda 2 vjetësh pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.	E plotë	
Neni 3, pika 5, paragrafi i fundit	Të gjitha vlerat kufi të krijuara do të publikohen në planet e menaxhimit të baseneve lumore, do të dorëzohen në përputhje me Nenin 13 të Direktivës		Neni 61, pika 5	5. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore sigurohet që të gjitha vlerat prag të përcaktuara të publikohen në planet e menaxhimit të baseneve lumore,	E plotë	Referenca e vendosur në nenin 3 pika 5, paragrafi i fundit e Direktivës (neni 13 i Direktivës 2000/60) është transpozuar plotësisht nga

	2000/60/KE, dhe duke përfshirë një përmbledhje të informacionit të përcaktuar Pjesën C të Aneksit II të kësaj Direktive.			që miratohen dhe publikohen në përputhje me nenin 53 të këtij ligji.		parashikimet e projektligjit (neni 53)
Neni 3, pika 6	<p>Shtetet Anëtare do të amendojnë listën e vlerave kufi kurdoherë, kur informacioni i ri për ndotësit, grupet e ndotësve ose indikatorët e ndotjes tregojnë që duhet të vendoset vlera kufi për një substancë plotësuese, që duhet të amendohet një vlerë kufi ekzistuese, ose që një vlerë kufi e hequr më parë nga lista duhet të ri futet, në mënyrë që të mbrohet shëndeti i njeriut dhe mjedisi.</p> <p>Vlerat kufi mund të hiqen nga lista kur një trup i ujërave nëntokësore në fjalë nuk është më në rrezik nga ndotësit, grupet e ndotësve ose indikatorët e ndotjes përkatëse.</p> <p>Cdo ndryshim i tillë në listën e vlerave kufi do të raportohet në kontekstin e rishikimi periodik të planeve të menaxhimit të baseneve lumore.</p>		Neni 61, pika 6	6. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore propozon ndryshimin e listës së vlerave prag sa herë që informacioni i ri për ndotësit, grupet e ndotësve, ose treguesit e ndotjes tregon se duhet të përcaktohet vlerë prag për një substancë shtesë, kur vlera prag ekzistuese duhet të ndryshohet, ose kur vlera prag e hequr më parë duhet të rifutet në listë, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit. Vlerat prag mund të hiqen nga lista kur trupi ujqor nëntokësor në fjalë nuk është më në risk nga ndotësit, grupet e ndotësve apo treguesit e ndotjes përkatës. Këto ndryshime të vlerave prag në listë raportohen në kuadër të shqyrtimit periodik të planeve të menaxhimit të baseneve lumore.	E plotë	
Neni 4, pika 1	Shtetet Anëtare do të përdorin procedurën e përshkruar në paragrafin 2 për të vlerësuar statusin kimik të një trupi të		Neni 63, pika 1	1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore përcakton procedurën për vlerësimin e statusit kimik të ujërave	E plotë	

	ujërave nëntokësore. Aty ku është e përshtatshme, Shtetet Anëtare ,gjatë kryerjes së kësaj procedure mund të grupojnë trupat e ujërave nëntokësore në përputhje me Aneksin V të Direktivës 2000/60/KE .			nëntokësorë. Për qëllim të kësaj procedure, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore mund t'i grupojë trupat ujqorë nëntokësorë sipas Rajoneve të Baseneve lumore, të përcaktuara sipas nenit 13 këtij ligji.		
Neni 4, pika 4	Shtetet Anëtare do të publikojnë një përmbledhje të vlerësimit të statusit kimik të ujërave nëntokësore në planet e menaxhimit të baseneve ujqore, në përputhje me Nenin 13 të D Kjo përmbledhje, e krijuar në nivel të rrethit të basenit lumore ose të pjesës të rrethit të basenit lumor ndërkombëtar që bie nën territorin e një Shteti Anëtar, do të përfshijë gjithashtu një shpjegim, për mënyrën se si janë marrë në konsideratë në vlerësimin përfundimtar, tejkalimet e standarteve të cilësisë mjedisore dhe të vlerave kufi në pika individuale monitorimi. direktivës 2000/60/KE.		Neni 63, pika 2	2. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore përfshin informacion për vlerësimin e statusit kimik të ujërave nëntokësorë në planet e menaxhimit të baseneve lumore në përputhje me këtë ligj. Ky informacion përfshin edhe një shpjegim lidhur me mënyrën se si janë marrë në konsideratë tejkalimet e standardeve të cilësisë së ujërave nëntokësorë apo vlerat prag në pika individuale monitorimi.	E plotë	
Neni 4, pika 2	2. Një trup ose grup trupash të ujërave nëntokësore do të konsiderohen se kanë një status të mirë kimik kur:  (a) monitorimi përkatës tregon që janë plotësuar kushtet		Neni 63, pika 3	3. Këshilli i Ministrave, me propozim të Kryeministrit, miraton procedurën për vlerësimin e statusit kimik të ujërave nëntokësorë, brenda 4 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.	E pjesëshme	Duke qenë se pika 3 e nenit 63 autorizon KM për nxjerrjen e aktit nënligjor, pika 2 e nenit 4 të Direktivës do të përafrohet plotësisht me miratimin e këtij akti.

	<p>e përcaktuara në Tabelën 2.3.2 të Aneksit V të Direktivës 2000/60/KE; ose</p> <p>(b) vlerat për standartet e cilësisë të ujërave nëntokësore të rënditura në Aneksin I dhe vlerat kufi përkatëse të përcaktuara në përputhje me Nenin 3 dhe Aneksin II, nuk janë tejkalluar në asnjë pikë monitorimi në atë trup ose grup trupash të ujërave nëntokësore; ose</p> <p>(c) vlera për një standart cilësie mjedisor ose vlera kufi është tejkaluar në një ose më shumë pika monitorimi por kjo konfirmohet nga një kontroll i duhur në përputhje me Aneksin III;</p> <p>(i) në bazë të vlerësimit të referuar në paragrafin 3 të Aneksit III, përqëndrimet e ndotësve që tejkalojnë standartet e cilësisë mjedisore ose vlerat kufi nuk konsiderohen që paraqesin një rrezik mjedisor domethënës, duke marrë parasysh, ku është e përshtatshme, shtrirjen e trupit të ujërave nëntokësore që është i prekur;</p>					
--	--	--	--	--	--	--



	<p>(ii) janë plotësuar kushtet e tjera për status të mirë kimik të ujërave nëntokësore, përcaktuar në Tabelën 2.3.2 në Aneksin V të Direktivës 2000/60/KE, në përputhje me paragrafin 4 të Aneksit III të kësaj Direktive;</p> <p>(iii) për trupat e ujërave nëntokësore të identifikuar në përputhje me Nenin 7(1) të Direktivës 2000/60/KE, janë plotësuar kërkesat e Nenit 7(3) të asaj Direktive, në përputhje me paragrafin 4 të Aneksit III të kësaj Direktive;</p> <p>(iv) aftësia e trupit të ujërave nëntokësore ose të ndonjë prej trupave në grupin e trupave të ujërave nëntokësore që ndihmon përdorimet e njeriut nuk është dëmtuar në mënyrë të konsiderueshme nga ndotja,</p>					
Neni 5, pika 1	Shtetet Anëtare do të identifikojnë tendencat domethënëse dhe të qëndrueshme në rritje të ndotësve, grupeve të ndotësve ose indikatorëve të ndotjes të gjetura në trupat ose grupet e trupave të ujërave nëntokësore, të identifikuar që janë në rrezik dhe të përcaktojnë pikën e fillimit për ndryshimin e kësaj		Neni 64, pika 1, pika 6, pika 7	1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore identifikon të gjitha rastet kur përqëndrimi i ndotësve, grupeve të ndotësve, ose treguesve të ndotjes në trupat ujorë nëntokësorë apo grupime të tyre të identifikuar me risk, ka prirje rritëse të qëndrueshme dhe përcakton pikën fillestare për përmbysjen e kësaj prirjeje.	E pjesshme	Duke qenë se pika 7 e nenit 64 autorizon KM për nxjerrjen e aktit nënligjor, pika 1 e nenit 5 të Direktivës do të përafrohet plotësisht me miratimin e këtij akti, duke përfshirë edhe aneksin IV.

	tendence, në përputhje me Aneksin IV.			6. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore harton metodologjinë për identifikimin e prirjeve rritëse të qëndrueshme dhe përcaktimin e pikës fillestare për përmbysjen e prirjes. 7. Këshilli i Ministrave, me propozim të Kryeministrit, miraton metodologjinë e hartuar sipas pikës 6 të këtij neni, brenda 4 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.		
Neni 5, pika 2	Shtetet Anëtare, në përputhje me Pjesën B të Aneksit IV, duhet të ndryshojnë tendencat të cilat paraqesin një rrezik domethënës që dëmton cilësinë e ekosistemeve ujore dhe ekosistemeve tokësore, shëndetin e njeriut ose përdorimin potencial legjitim të mjedisit ujor, nëpërmjet programit të masave referuar në Nenin 11 të Direktivës 2000/60/KE, në mënyrë që të reduktohet në mënyrë progresive ndotja dhe parandalimi i përkeqësimit të ujërave nëntokësore.		Neni 64, pika 2	2. Me qëllim uljen progresive të ndotjes dhe parandalimin e përkeqësimit të ujërave nëntokësore, përmes programeve të masave të ndërmarra në përputhje me nenin 51 të këtij ligji, sigurohet përmbysja e prirjeve që paraqesin risk për cilësinë e ekosistemeve ujore apo tokësore, për shëndetin njerëzor, ose përdorimeve të burimeve ujore.	E plotë	Referenca e vendosur në nenin 5, pika 2 e Direktivës, (neni 11 i Direktives 2000/60) është transpozuar nga parashikimet e projektligjit. (nenet 44, 45, 46, 47 pikat 1 dhe 2, 48 pika 1, 49, 50, 51, 58 pika 1a 1b, 65 të projektligjit)
Neni 5, pika 3	Shtetet Anëtare do të përcaktojnë pikat e fillimit për ndryshimin e tendencave si një përqindje të nivelit të standarteve të cilësisë të ujërave nëntokësore të përcaktuara në Aneksin I dhe të vlerave kufi të		Neni 64, pika 3	3. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore përcakton pikën fillestare për përmbysjen e prirjes rritëse si përqindje të nivelit të standardeve të cilësisë së ujërave nëntokësore dhe të vlerave kufi të përcaktuara, bazuar në prirjen e	E plotë	Neni 3 i Direktivës është transpozuar nga parashikimet e projektligjit. (neni 62, pika 1)

	përcaktuara në përputhje me Nenin 3, në bazë të tendencës së identifikuar dhe rrezikut mejdisor të shoqëruar më të, në përputhje me Pjesën B, pika 1 të Aneksit IV.			identifikuar dhe riskun mjedisor të lidhur me të.		
Neni 5, pika 4 germa (a)	Në planet e menaxhimit të baseneve ujore që do të dorëzohen në përputhje me Nenin 13 të Direktivës 2000/60/KE, Shtetet Anëtare do të përmbledhin:  (a) mënyrën sesi vlerësimi i tendencës, nga pika individuale monitroimi brënda një trupi ose grupi trupash të ujërave nëntokësore, në përputhje me Seksionin 2.5 të Aneksit V të asaj Direktive, ka kontribuar në identifikimin që këto trupa janë subjekt i një tendence domethënëse dhe të qëndrueshme në rritje, në një përqëndrim të cdo ndotësi ose një ndryshim i asaj tendence; dhe		Neni 64, pika 4, germa (a)	4. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore përfshin në planet e menaxhimit të baseneve lumore informacion për: a) mënyrën në të cilën vlerësimi i prirjes nga pikat individuale të monitorimit në një trup apo një grup trupash ujorë nëntokësorë ka kontribuar në identifikimin, në përputhje me pikën 1 të këtij neni, se këta trupa janë të ndikuar nga një prirje rritëse e konsiderueshme dhe e qëndrueshme e përqëndrimit të ndotësve, apo të përmbysjes së kësaj prirje; dhe	E plotë	Referenca e vendosur në nenin 5 pika 4, germa (a) e Direktivës (neni 13 i Direktivës 2000/60) është transpozuar plotësisht nga parashikimet e projektligjit (neni 53)
Neni 5, pika 4 germa (b)	(b) arsyet për pikat e fillimit të përcaktuara në përputhje me paragrafin 3.		Neni 64, pika 4, germa (b)	b) arsyet për përcaktimin e këtyre pikave fillestare në përputhje me pikën 3 të këtij neni.	E plotë	
Neni 5, pika 5	Kur është e vevojshme për të vlerësuar impaktin e shtëllungave/plumes ekzistuese të ndotjes të ujërave nëntokësore që mund të		Neni 64, pika 5	5. Kur identifikohen ndotje të përqëndruara që mund të rrezikojë arritjen e objektivave të cilësisë mjedisore të përcaktuara në përputhje me nenin 61 të këtij	E plotë	Referenca e vendosur në nenin 5, pika 5 e Direktivës (neni 13 i Direktivës 2000/60) është përafëruar plotësisht nga parashikimet e

	<p>rrezikojnë arritjen e objektivave të Nenin 4 të Direktivës 2000/60/KE, dhe në vecanti, kur këto shtëllunga vijnë nga pikat e burimit dhe nga toka e ndotur, Shtetet Anëtare do të kryejnë vlerësime tendencash shtesë për ndotës të identifikuar në mënyrë që të verifikohet që shtëllungat nga vende të ndotura nuk zgjerohen, nuk përkeqesojnë statusin kimik të trupit ose grupeve të trupave të ujërave nëntokësore, dhe nuk paraqesin një rrezik për shëndetin e njeriut dhe mejdisin. Rezultatet e këtyrë vlerësimeve do të përmblihen në planet e menaxhimit të baseneve lumore që do të dorëzohet në përputhje me Nenin 13 të Direktivës 2000/60/KE.</p>			<p>ligji, është e nevojshme të vlerësohet ndikimi i tyre në trupat ujqorë nëntokësorë dhe në veçanti për ato ndotje të përqëndruara që vijnë si pasojë e burimeve pikësore të ndotjes dhe tokave të ndotura, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore ndërmerr vlerësime shtesë të prirjeve për ndotësit e identifikuar me qëllim verifikimin që ndotjet e përqëndruara të mos përhapen, të mos përkeqësojë statusin kimik të trupit apo të trupave ujqorë nëntokësorë, dhe të mos paraqesin risk për shëndetin njerëzor dhe mjedisin. Rezultatet e këtyrë vlerësimeve përfshihen në planet e menaxhimit të baseneve lumore.</p>		<p>projektligjit. ( neni 53 pikat 1 2 3 4 6 dhe neni 174 të projektligjit)</p>
<p>Neni 6 , pika 1, paragrafi 1(a)</p>	<p>1. Për të arritur objektivin e parandalimit ose kufizimit të inputeve të ndotësve në ujërat nëntokësore, krijuar në përputhje me Nenin 4(1) (b) (i) të Direktivës 2000/60/KE, Shtetet Anëtare do të sigurojnë që programi i masave të krijuara në përputhje me Nenin 11 të asaj Direktive përfshin:</p>		<p>Neni 66, pika 1 (a)</p>	<p>1. Me qëllim arritjen e objektivit për parandalimin apo kufizimin e depërtimit të ndotësve në ujërat nëntokësorë, të përcaktuar në përputhje me nenin 56 të këtij ligji, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore në programin e masave të përcaktuar në nenin 44 të këtij ligji, përfshin:</p> <p>a) të gjitha masat për të parandaluar depërtimin e substancave të përcaktuara si të</p>	<p>E plotë</p>	<p>Referenca e vendosur në (nenin 6 , pika 1, paragrafi 1), është transpozuar nga parashikimet e projektligjit. (neni 56 pika 2)</p>

	<p>(a) të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar inputet në ujërat nëntokësore të cdo substance të rrezikshme, pa cënuar paragrafët 2 dhe 3. Në identifikimin e këtyre substancave, Shtetet Anëtare, në vecanti duhet të marrin në konsideratë substancat e rrezikshme që i përkasin familjeve ose grupeve të ndotësve referuar në pikën 1 deri 6 të Aneksit VIII të Direktivës 2000/60/KE, si edhe substancat që i përkasin përkasin familjeve ose grupeve të ndotësve referuar në pikën 7 deri 9 të atij Aneksi, kur këto konsiderohen të rrezikshme.</p>			<p>rrezikshme sipas pikës 4 të këtij neni në ujërat nëntokësore, përveç atyre rasteve sipas parashikimeve të pikave 5 dhe 6 të këtij neni.</p>		
<p>Neni 6 , pika 1, paragrafi 1(b)</p>	<p>(b) për ndotësit e rënditur në Aneksin VIII të Direktivës 2000/60/KE të cilat nuk konsiderohen të rrezikshme, dhe cdo ndotës tjetër jo i rrezikshëm që nuk është rënditur në atë Aneks, që konsiderohet nga Shtetet Anëtare se paraqesin një rrezik ekzistues ose potencial për ndotje, të gjithat masat e nevojshme për të kufizuar inputet në ujërat nëntokësore si edhe për të siguruar që inpute tilla nuk shkaktojnë përkeqësim</p>		<p>Neni 66, pika 1(b), 2 dhe pika 4</p>	<p>b) të gjitha masat e nevojshme për të kufizuar depërtimin në ujërat nëntokësore e atyre substancave të cilat nuk janë të rrezikshme duke siguruar shmangien e përkeqësimit ose prirjen rritëse të konsiderueshme dhe të qëndrueshme të përqendrimeve të ndotësve në ujërat nëntokësore për substancat e përcaktuara si jo të rrezikshme sipas pikës 4 të këtij neni, dhe për ndotësit e tjerë jo të rrezikshëm që nuk janë të përfshirë në listën indikative sipas pikës 3 të këtij</p>	<p>E plotë</p>	

	<p>ose tendenca domethënëse në rritje në përqëndrimet e ndotësve në ujërat nëntokësore. Këto masa duhet të marrin parasysh, të paktën, praktikën më të mirë të krijuara, duke përfshirë Praktikën më të Mirë Mjedisore dhe Teknikat më të Mira në Dispozicion të specifikuar në legjislacionin përkatës të Komunitetit.</p>			<p>neni, për të cilat Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore vlerëson se paraqesin ose mund të paraqesin risk për ndotje.</p> <p>2. Për përcaktimin e masave të parashikuara në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij neni, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore merr në konsideratë praktikën e mirë të krijuar, përfshi praktikën më të mirë mjedisore, atëherë kur është e mundur. Për qëllimet e përcaktimit të masave të cituara në pikën 1 të këtij neni, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore përpara identifikimit të listës indikative të ndotësve sipas pikës 3 të këtij neni, vlerëson rrethanat në të cilat këto ndotës, veçanërisht metalet kryesore dhe komponimet e tyre, identifikohen si të rrezikshëm ose jo.</p> <p>4. Këshilli i Ministrave, me propozim të Kryeministrit, miraton listën indikative të ndotësve të identifikuar sipas pikës 3 të këtij neni, brenda 4 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.</p>		
<p>Neni 6, pika 1, paragrafi 2</p>	<p>Për qëllim të krijimit të masave të referuara në pikat (a) ose (b), Shtetet Anëtare, si hap të parë, mund të identifikojnë rrethanat në të cilat ndotësit e rënditur në Aneksin VIII të Direktivës 2000/60/KE, në vecanti</p>		<p>Neni 66, pika 2</p>	<p>2. Për përcaktimin e masave të parashikuara në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij neni, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore merr në konsideratë praktikën e mirë të krijuar, përfshi praktikën më të mirë mjedisore, atëherë kur</p>	<p>E plotë</p>	

	metalet kryesore dhe komponimet e tyre të referuar në pikën 7 të atij Aneksi, duhet të konsiderohen të rrezikshme ose jo të rrezikshme.			është e mundur. Për qëllimet e përcaktimit të masave të cituara në pikën 1 të këtij neni, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore përpara identifikimit të listës indikative të ndotësve sipas pikës 3 të këtij neni, vlerëson rrethanat në të cilat këto ndotës, veçanërisht metalet kryesore dhe komponimet e tyre, identifikohen si të rrezikshëm ose jo.		
Neni 6, pika 2	Inputet e ndotësve nga burime të shpërndara të ndotjes që kanë një impakt në statusin kimik të ujërave nëntokësore duhet të merren në konsiderate kurdohere që është teknikisht e mundur.		Neni 66, pika 5	5. Ndikimi nga depërtimi i ndotësve nga burimet e shpërndara të ndotjes që kanë ndikim në statusin kimik të ujërave nëntokësore merret në konsideratë kur kjo gjë është e mundur nga pikëpamja teknike.	E plotë	
Neni 6, pika 3, germa (a)	3. Pa cënuar ndonjë masë më të rreptë në legjislacione të tjera të Komunitetit, Shtetet Anëtare mund të përjashtojnë nga masat e kërkuara nga paragrafi 1, inputet e ndotësve që janë:  (a) rezultati i shkarkimeve të drejtëpërdrejta të autorizuara në përputhje me Nenin 11(3) (j) të Direktivës 2000/60/KE;		Neni 66, pika 6, germa (a)	6. Pa shkelur asnjë nga kërkesat më shtrënguese të parashikuara në akte të tjera ligjore, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore mund të përjashtojë nga masat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni depërtimin e ndotësve që: a) gjenerohen nga shkarkimet e drejtëpërdrejta në përputhje me nenin 65 të këtij ligji;	E plotë	Nenet 11(3) (j) të Direktivës 2000/60/KE, janë në përputhje me parashikimet e këtij projektligji. ( neni 65 pikat 1 dhe 2)
Neni 6, pika 3, germa (b)	(b) konsideruar nga autoritetet kompetente se janë të një sasi dhe përqëndrimi aq të vogël sa të shmangin rrezikun e përkeqësimit në të ardhmen		Neni 66, pika 6, germa (b)	b) janë në sasi dhe përqëndrim aq të vogël sa konsiderohen të mos përbëjnë rrezik për përkeqësimin e cilësisë së ujërave nëntokësore pritëse;	E plotë	

	në cilësinë e ujërave nëntokësore marrëse;					
Neni 6, pika 3, germa (c)	(c) pasojat e aksidenteve ose rrethanave të jashtëzakonshme të shkaqeve natyrore që mund të mos jenë parashikuar, evituar apo zbutur në mënyrë të arsyeshme.		Neni 66, pika 6, germa (c)	c) janë pasojë e aksidenteve ose rrethanave të jashtëzakonshme për shkaqe natyrore që nuk mund të parashikoheshin, shmangeshin, apo zbuteshin në mënyrë të arsyeshme;	E plotë	
Neni 6, pika 3, germa (d)	(d) rezultati i rimbushjes artificiale ose shtimit të trupave të ujërave nëntokësore të autorizuar në përputhje me Nenin 11(3) (f) të Direktivës 2000/60/KE;		Neni 66, pika 6, germa (ç)	ç) janë rezultat i rimbushjes apo shtimit artificial të trupave ujorë nëntokësorë të autorizuar në përputhje me nenin 58 të këtij ligji;	E plotë	Referenca e vendosur në nenin 6, pika 3, germa (d) (Neni 11(3) (f) i Direktivës 2000/60/KE), është përfruar plotësisht nga parashikimet e projektligjit (neni 58)
Neni 6, pika 3, germa (e)	(e) në funksion të autoriteteve kompetente, ku për arsye teknike janë të paafta për të parandaluar ose kufizuar pa përdorur:		Neni 66, pika 6, germa (d)	d) për arsye teknike, nuk mund të parandalohen apo të kufizohen vetëm përmes masave:	E plotë	
Neni 6, pika 3, germa (e), (i)	(i) masat që do të rrisin rrezikun ndaj shëndetit të njeriut ose ndaj cilësisë të mjedisit si një i tërë; ose		Neni 66, pika 6, germa (d), (i)	i) që do të rrisnin riskun ndaj shëndetit njerëzor ose cilësisë së mjedisit në tërësi; ose	E plotë	
Neni 6, pika 3, germa (a), (ii)	(ii) masat me kosto disproporcionale për të hequr sasitë e ndotësve nga, ose ndryshe kontrollin e filtrimit të tyre në, tokë ose nën dherat/tabani të ndotura; ose		Neni 66, pika 6, germa (d), (ii)	ii) me kosto të larta dhe të papërligjura për të larguar sasitë e ndotësve, ose për të kontrolluar depërtimin e tyre në tokën apo nënshtresën e ndotur të tokës;	E plotë	
Neni 6, pika 3, germa (f)	(f) rezultati i ndërhyrjeve në ujërat sipërfaqësore me qëllim, midis të tjerave, të lehtësimit të efekteve të përmblyetjeve dhe thatësirave,		Neni 66, pika 6, germa (dh)	dh) vijnë si pasojë e kryerjes së ndërhyrjeve në ujërat sipërfaqësore, me qëllim zbutjen e efekteve të përmblyetjeve dhe thatësirave, menaxhimin e ujërave	E plotë	Referenca e vendosur në nenin 6, pika 3 germa (f) është në përputhshmëri të plotë me parashikimet e



	dhe për menaxhimin e ujërave dhe rrugëve të ujërave, duke përfshirë edhe në nivel ndërkombëtar. Aktivitete të tilla, duke përfshirë prerjen, drenazhimin, zhvendosjen dhe depozitimin e sedimenteve në ujërat sipërfaqësore, duhet të kryhen në përputhje me rregullat e përgjithshme detyruese, dhe, kur është e zbatueshme, me leje dhe autorizime të lëshuara në bazë të këtyre rregullave, të hartuara në Shtetet Anëtare për këtë qëllim, duke siguruar që këto inpute nuk kompromentojnë arritjen e objektivave mjedisore për trupat ujorë në fjalë, në përputhje me Nenin 4(1) (b) të Direktivës 2000/60/KE.			dhe të rrjedhave ujore, përfshi edhe ujërat ndërkufitare. Këto ndërhyrje, përfshi gërryerjen, gërmimin, zhvendosjen dhe depozitimin e sedimenteve në ujëra sipërfaqësore, kryhen në përputhje me rregullat e përgjithshme detyruese dhe kur gjen zbatim, me lejet dhe autorizimet e lëshuara nga organet e menaxhimit të burimeve ujore për këtë qëllim, me kusht që këto depërtime të mos vënë në rrezik arritjen e objektivave mjedisore të përcaktuara për trupat ujorë në fjalë, në përputhje me nenin 20 të këtij ligji.		projekligjit. ( neni 56, pika 2 gerrat a dhe b)
Neni 6, pika 3, paragrafi i fundit	Përjashtimet e parashikuara në pikat (a) deri (f) mund të përdoren vetëm kur autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare kane krijuar monitorimin efikas të trupave të ujërave nëntokësore në fjalë, në përputhje me pikën 2.1.2 të Aneksit V të Direktivës 2000/60/KE, ose nëse po kryhen monitorime të tjera të përshtatshme.		Neni 66, pika 7	7. Përjashtimet e përcaktuara në pikën 6 të këtij neni, gjejnë zbatim vetëm në ato raste kur kryhet monitorim efektiv i satusit kimik të trupave ujorë nëntokësore, në përputhje me nenin 65 të këtij ligji, apo veprimtari të tjera monitorimi.	E plotë	
Neni 6, pika 4	Autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare duhet të mbajnë një inventar të		Neni 66, pika 8	8. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore mban një inventar të përjashtimeve të bëra	E plotë	

	përgjashtimeve referuar në paragrafin 3 me qëllim të njohimit, me kërkesë, te Komisioni.			në përputhje me pikën 6 të këtij neni, me synim informimin publik.		
--	--	--	--	--	--	--